



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari i Komunës

---

**RAPORT**  
**PËR SITUATEN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE**  
**INVESTUESE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2018**

Shtator 2018

Në këtë raport është paraqitur puna dhe aktiviteti i kryetarit, përkatësisht qeverisë komunale për periudhën janar qershor 2018, duke i dhënë akcent të posaçëm implementimit të planeve investuese të komunës (projekteve kapitale), të planifikuara dhe të atyre që nuk kanë qenë të planifikuara, por që janë realizuar me bashkëfinancim me donatorë të ndryshëm.

Në vijim të këtij raporti janë të pasqyruara punët që janë kryer sipas drejtorive e që janë në kompetencë dhe përgjegjësi të komunës, duke përfshirë edhe ato lidhur me implementim apo realizim të projekteve kapitale, planifikimet buxhetore sipas kategorive sikur që janë kategoria e shpenzimeve komunale, shpenzimet për mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere etj.

### **Buxhet dhe financa**

#### **Planifikimi i buxhetit**

- Paga dhe mëditje..... 4,880,652.90€
- Mallra dhe shërbime..... 1,355,271.76€
- Shpenzime komunale..... 147,802.97€
- Subvencione dhe transfere..... 172,079.00€
- Investime kapitale..... 4,274,372.68€

**Totali..... 10,830,179.31€**

#### **Forma tabelare: Buxheti i planifikuar dhe shpenzimet e realizuara**

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese (janar-qershor 2018)		
		Buxheti i planifikuar për PR	Shpenzimet e realizuara në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar
		4	5	6 = 5/4*100
		€	€	%
Paga dhe mëditje	111	4,880,652.90	4,858,791.03	100%
Mallra dhe shërbime	130	1,355,271.76	641,785.44	47%
Shpenzime komunale	132	147,802.97	133,340.42	90%
Subvencione dhe transfere	200	172,079.00	69,005.00	40%
Investime kapitale	300	4,274,372.68	494,169.85	12%
<b>TOTALI</b>		<b>10,830,179.31</b>	<b>6,197,091.74</b>	<b>57%</b>

PËRMBLEDHJE E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese (janar-qershor 2018)		
		Buxheti i planifikuar për PR €	Shpenzimet e realizuara në PR €	% %
Zyra e Kryetarit	160	118,709.90	102,720.72	87%
Administrata dhe personeli	163	335,537.15	146,890.46	44%
Inspektimet	166	61,265.96	45,012.15	73%
Prokurimi	167	16,879.47	14,408.27	85%
Zyra e Kuvendit komunal	169	69,355.87	66,578.67	96%
Buxheti dhe financat	175	103,473.72	90,159.02	87%
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	1,629,690.44	633,379.13	39%
Zyra lokale e komuniteteve	195	22,711.54	21,032.90	93%
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	369,938.27	145,244.82	39%
Gjeodezi dhe kadastër	650	142,266.27	37,558.29	26%
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,194,143.78	27,527.71	2%
Shëndetësia primare	730	1,147,154.61	827,405.99	72%
Shërbimet sociale rezidenciale		178,469.05	93,318.94	52%
Kulturë, rini, sport	850	673,645.93	188,603.27	28%
Arsimi	920	4,766,937.35	3,757,251.40	79%
<b>TOTALI</b>		<b>10,830,179.31</b>	<b>6,197,091.74</b>	<b>57%</b>

Realizimi i buxhetit për periudhën janar – qershor/2018

- Paga dhe mëditje ..... 4,858,791.03€
- Mallra dhe shërbime..... 641,785.44€
- Shpenzime komunale..... 133,340.42€
- Subvencione dhe transfero..... 69,005€
- Investime kapitale..... 494,169.85€

**Totali i shpenzimeve..... 6,197,091.74€**

**Realizimi i shpenzimeve është.. ..... 57%**

Planifikimi i të hyrave për periudhën janar – qershor/2018

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese (PR)		
		Buxheti i planifikuar	Të hyrat e realizuara	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR
		4	5	6 = 5/4*100
<b>Administrata dhe personeli</b>	<b>163</b>	€	€	%
Taksa administrative		40,000.00	34,621.00	87%
<b>TOTAL</b>		<b>40,000.00</b>	<b>34,621.00</b>	<b>87%</b>
<b>Inspektimet</b>	<b>166</b>	€	€	%
Të hyrat nga inspektimet		8,000.00	4,662.33	58%
				0%
				0%
<b>TOTAL</b>		<b>8,000.00</b>	<b>4,662.33</b>	<b>58%</b>
<b>Buxhet dhe Financa</b>	<b>175</b>	€	€	%
Taksat e firmave		25,000.00	23,695.00	95%
Tatimi në pronë			307,281.5	
Transaksionet		336,639.50	4	91%
				0%
<b>TOTAL</b>		<b>361,639.50</b>	<b>330,976.5</b>	<b>92%</b>
<b>Arsimi</b>	<b>900</b>	€	€	%
Shitja e prodhimeve bujqësore,		0.00	200.40	#DIV/0!
participimi në çerdhen e fëmijëve,		20,000.00	19,006.30	95%
shkolla e mesme teknike,		8,500.00	6,920.00	81%
shkolla e mesme profesionale		8,000.00	7,280.00	91%
<b>TOTAL</b>		<b>36,500.00</b>	<b>33,406.70</b>	<b>92%</b>
<b>Gjeodezi dhe kadastrë</b>	<b>650</b>	€	€	%
		0.00		0%
Të hyrat nga gjeodezia dhe kadastrë		47,500.00	52,875.00	111%
<b>TOTAL</b>		<b>47,500.00</b>	<b>52,875.00</b>	<b>111%</b>

<b>Kulturë, rini dhe sport</b>	<b>850</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>%</b>
		0.00		
Palestra e sportit,		1,000.00	744.00	74%
biblioteka,		500.00	93.00	19%
shtëpia e kulturës		250.00	20.00	8%
<b>TOTAL</b>		<b>1,750.00</b>	<b>857.00</b>	<b>49%</b>
<b>Shërbime publike</b>	<b>180</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>%</b>
		0.00		0%
Parkingjet,		2,500.00	2,442.42	98%
taksat për mbeturina,		311,044.50		0%
taksat rrugore		50,000.00	51,720.50	103%
<b>TOTAL</b>		<b>363,544.50</b>	<b>54,162.92</b>	<b>15%</b>
<b>Bujqësi</b>	<b>470</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>%</b>
Ndryshimi i destinimit të tokës,		50,000.00	17,301.00	35%
leje pune			120.00	
<b>TOTAL</b>		<b>50,000.00</b>	<b>17,421.00</b>	<b>35%</b>
<b>Shëndetësi</b>	<b>700</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>%</b>
Participim,		22,500.00	21,211.00	94%
participim QPS		1,250.00	1,210.00	97%
<b>TOTAL</b>		<b>23,750.00</b>	<b>22,421.00</b>	<b>94%</b>
<b>Urbanizmi</b>	<b>660</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>%</b>
Lejet e ndërtimit,		150,000.00	54,930.70	37%
shfrytëzimi i pronës publike		20,000.00	37,187.91	186%
<b>TOTAL</b>		<b>170,000.00</b>	<b>92,118.61</b>	<b>54%</b>
	<b>850</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>%</b>
Gjobat e trafikut,		25,000.00	37,650.00	151%
gjobat e gjykatave,		10,000.00		0%
të hyrat tjera			210.00	#VALUE!
<b>TOTAL</b>		<b>35,000.00</b>	<b>37,860.00</b>	<b>108%</b>
		1,137,684.0	681,382.1	
		0	0	60%

Planifikimi ..... 1,137,684.00€  
Realizimi ..... 681,382.10€  
Shprehur në % është ..... 60%

## Ekonomi, bujqësi, pylltari

### Sektori i bizneseve

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, bën përpjekje që të përmirësojë maksimalisht kushtet e të bërit biznes dhe që konform ligjeve, të mbështesë bizneset drejt zhvillimit të tyre të mëtejshëm, si dhe të krijojë kushte për zbutjen e papunësisë, të krijojë një klimë edhe më të favorshme për të gjitha bizneset që operojnë në territorin e komunës. Në këtë periudhë vërehet një interesim më i madh i pronarëve për të hapur biznese bujqësore (prodhuese) për shkak të subvencioneve që përfitojnë nga donatorët e ndryshëm. Komuna ka ofruar grante për biznese fillestare dhe për bizneset ekzistuese, të cilat kanë synuar ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre dhe njëherazi ta rrisin numrin e punëtorëve, kurse vlera e këtyre granteve është 90.000 €. Për bizneset fillestare shuma e grantit është deri 1500€, ndërkaq për bizneset ekzistuese shuma e grantit është prej 2000 deri 2500 €.

Qendra Kosovare e Biznesit funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë dhe pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare. Është në zbatim aplikimi online i regjistrimit të biznesit, ku aplikuesi mund të pajiset drejtpërdrejt me certifikatë biznesi. Sistemi i tanishëm ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Evropian.

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	<b>Biznese të reja</b> (të regjistruara) individuale	100	
2.	<b>Biznese të reja</b> (të regjistruara), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)	45	
3.	<b>Biznese të shuara</b>	29	
4.	<b>Ndërrime të logove të certifikatave</b>	50	
5.	<b>Ndryshime në bizneset ekzistuese</b>	71	

Pasqyra tabelare e bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 1.1 – 30.6.2018

1	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	13	8.97
2	Industria përpunuese	23	15.87
3	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë	1	0.68
4	Ndërtimtaria	15	10.35
5	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i	35	24.14

	automjeteve dhe aparateve tjera të amvisërisë		
6	Hotelet dhe restorantet	14	9.66
7	Transporti, depot dhe telekomunikacioni	16	11.04
8	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	10	6.89
9	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale	2	1.38
10	Arsimi	3	2.06
11	Aktivitete tjera shoqërore dhe personale	13	8.96
	Totali	145	100

### Sektori i bujqësisë

Gjatë këtij gjashtëmujori në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve me të cilat iu është dhënë mbështetje bujqve të komunës që do të paraqiten si në vijim:

#### Subvencionet nga Ministria e BPZHR

Sipërfaqe të mbjella me grurë, kanë aplikuar 724 fermerë me sipërfaqe prej 2928.88 ha; me misër kanë aplikuar 531 fermerë me sipërfaqe prej 1468.86 ha; perime në fushë të hapur kanë aplikuar 402 fermerë me sipërfaqe prej 1744.60 ha; pemëtari kanë aplikuar 118 fermerë me sipërfaqe prej 53.05 ha; për dele dhe dhi kanë aplikuar gjithsej 45 fermerë; lopë qumështore kanë aplikuar gjithsej 365 fermerë; për bletë kanë aplikuar gjithsej 138 fermerë; shpezëtari kanë aplikuar gjithsej 3 fermerë; për derra kanë aplikuar 4 fermerë të nacionalitetit serb; për qumësht kanë aplikuar gjithsej 54 fermerë.

#### Projektet nga komuna

Serra me sipërfaqe prej 2 ari (200m<sup>2</sup>)

Nr	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Participimi i fermerëve	Komuna	Shuma
1	Projekti me serra	18	3,504.30€	51,000.00€	63,077.40€

Konservimi i barit-rotoballer, kanë përfituar 3 fermerë. Participimi: Përfituesit nga 5.000 €, komuna = 30.0000€, totali = 45.000 €.

#### Projektet në bashkëfinancim me IADK

Në bashkëpunim IADK me komunën tonë është realizuar projekti i ngritjes së pemishtes me arra ku kanë përfituar 6 (gjashtë) fermerë.

#### Projektet që janë në realizim (që janë në proces):

- Dredhëzat industriale prej 0.25ha për 10 ha (në proces).

- Bimë mjekuese aromatike (BMA) prej 0.25ha-1ha për 2.5ha (në proces) në bashkëfinancim me USAID-in. Komuna siguron sistemin e ujitjes pikë-pikë, ndërsa fidanët i sigurojnë nënkontraktuesit me USAID-in.
- Makina për nxjerrjen e qepëve 5 (pesë) makina apo përfitues.
- Makina për nxjerrjen e patateve 6 (gjashtë) përfitues.
- Mbulimi i normave të interesit (kredi – kamata) në proces, kamatën për përfituesit e kredive e mbulon komuna.
- Makinat për shpërndarjen e plehut organik.
- Grandet për biznese fillestare dhe ato më afarizëm dy e më tepër vite. Ky proces është në proces dhe do të përfitojnë mbi 60 biznese.

### Sektori i pylltarisë

Janë ndërmarrë masa për parandalim të prerjes ilegale të pyjeve nga prerësit ilegal, si dhe janë ngritur fletëparaqitje ndaj tyre në organet kompetente. Janë pranuar 3 punëtorë shtesë me kontratë për shërbime të veçanta për mbulim sa më të madh të terrenit. Gjithashtu është hartuar plani operativ në bashkëpunim me policinë, në ç'rast janë konfiskuar sasi të konsiderueshme të masës drusore.

Forma tabelare:

Nr.	PËRMBAJTJA	SASIA
1.	Kërkesa të paraqitura për leje-prerje	65
2.	Kërkesa të kryera	19 copa=792.42m <sup>3</sup>
3.	Damkosje, dru zjarri	423.23m <sup>3</sup>
5.	Fletëpagesa p. private	6copa=32.90€
7.	Konfiskime	14 raste =101.20m <sup>3</sup>
8.	Gjendja në depo	132.30 m <sup>3</sup>
10.	Fletëparaqitje për kundërvajtje dhe penale	69 copa=190.47m <sup>3</sup> = 22619.05€
11.	Plani i ripyllëzimeve	5 ha
12.	Kontrolle terreneve	39 raste

### Prokurimi publik

Drejtoria për Prokurim është angazhuar që t'i përmbushë gjitha kërkesat, përkatësisht t' i procesojë dhe kontrakttojë të gjitha projektet - prokurimet e parashikuara me planifikimin përfundimtar të aprovuar nga Kuvendi i komunës. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat lidhur me planifikimin dhe realizimin e prokurimeve për vitin 2018:

#### II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Nr.re-ndor	Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
1	Furnizim me material zyrtar	Kontratë kornizë me afat
2	Furnizim me derivate të naftës	AQP
3	Furnizim me orendi për zyra	Në realizim e sipër



4	Furnizim me veshmbathje	Në realizim e sipër
5	Furnizim me ushqim dhe pije	Kontratë kornizë me afat
6	Furnizim me material higjienik	Kontratë kornizë me afat
7	Furnizim me material për mirëmbajtje të objekteve të AK	Kontratë kornizë me afat
8	Furnizim me teknologji informative dhe pajisje të teknologjisë informative	Aktivitet i rezervuar për inicim nga AQP-ja
9	Furnizim me dru për ngrohje	Në realizim e sipër
10	Furnizim me thëngjill për ngrohje	Ky aktivitet nuk është inicuar, pasi që përdorimi i thëngjillit për ngrohje në shkolla është ndaluar nga MPHMM
11	Furnizim me aparate fotokopjuese	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
12	Furnizim me inventar për shkolla	Në realizim e sipër
13	Furnizim me inventar për objektin e ri të komunës	E realizuar
14	Furnizim me medikamente dhe material shpenzues medicinal për QKMF-në	Kontratë kornizë me afat
15	Furnizim me material stomatologjik	Kontratë kornizë me afat
16	Furnizim dhe instalim i pajisjeve të sistemit për menaxhimin e rendit	Në realizim e sipër
17	Furnizim me pajisje speciale mjekësore	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
18	Furnizim me aparaturë dhe mjete pune për QKMF-në	Në realizim e sipër
19	Furnizim me inventar për QKMF-në	Në realizim e sipër
20	Furnizim me automjet (autoambulancë)	Në realizim e sipër
21	Furnizim me automjet terreni me 5 ulëse dhe rimorkio	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
22	Furnizim dhe vendosje e kamerave në qytet	Në realizim e sipër
23	Furnizim me kontejnerë për mbeturina	E realizuar
24	Furnizim me makineri për nxjerr. e patates	Në fazën e inicimit të aktivitetit
25	Furnizim me makineri për nxjerr. e qepëve	Në fazën e inicimit të aktivitetit
26	Furnizim me makineri për konservimin e barit (rrotoballer)	E realizuar
27	Furn. me gypa për kanaliz. të ujërave të zeza	Kontratë kornizë me afat
28	Furnizim me pajisje për muzeun e qytetit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
29	Furnizim me pajisje për muzeun- Zyrën e turizmit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
30	Libra për bibliotekë	Në realizim e sipër
31	Furnizim me pajisje laboratorë për shkolla	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
32	Furnizim me pajisje për zjarrfikës	Në realizim e sipër

<b>33</b>	Furnizim me pajisje për shkolla	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
<b>34</b>	Furnizim me pajisje për qendrën rinore	Në fazën e inicimit të aktivitetit
<b>35</b>	Furnizim me materiale të shtypura për zyra	E kontraktuar nga MSH dhe MAP
<b>36</b>	Furnizim me pajisje tjera	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
<b>37</b>	Furnizim me preparate kimike	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
<b>38</b>	Furnizim me makineri për shpërndarjen e plehut organik	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
<b>39</b>	Furnizim me serra	E realizuar
<b>40</b>	Furnizim me pajisje për përkrahje të bizneseve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës

Duke u bazuar në planifikimin e prokurimeve për vitin fiskal 2018 sa i përket furnizimeve, nga gjithsej 40 prokurime të planifikuara janë iniciuar 30 projekte (furnizime) apo shprehur në përqindje 75% e prokurimeve të planifikuara, ndërsa të painicuar janë 10 apo shprehur në përqindje 25% të prokurimeve të planifikuara.

## II. 2) Kontratat për shërbime

Nr. Rendor	Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
1	Servisim i teknologjisë informative	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
2	Servisim i pajisjeve mjekësore	Në realizim e sipër
3	Shërbimet hoteliere	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
4	Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	Kontratë kornizë me afat
5	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
6	Botimet e reklamave dhe konkurseve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
7	Transporti i nxënësve	Kontratë kornizë me afat
8	Menaxhimi i mbeturinave	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
9	Servisimi dhe mbu. e aparat. kundër zjarrit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
10	Shërbimet e deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
11	Shërbimet e internetit	Kontratë kornizë me afat
12	Mirëmbajtja e varrezave	E realizuar
13	Sigurimi fizik i objekteve komunale, shkollave, QPS-së dhe QKMF-ve	Kontratë kornizë me afat (deri më 25 shtator)
14	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të AK-Vushtrri	Kontratë kornizë me afat (deri më 25 shtator)
15	Hartimi i projekteve	Në fazën e ritenderimit
16	Shtypja e materialeve të nevojshme për AK - Vushtrri dhe punimi i dekoratave	Kontratë kornizë me afat
17	Pastrimi dhe larja e rrugëve të qytetit	Inicuar nga DPP
18	Shërbimet e udhëtimit jashtë vendit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
19	Shërbimet e udhëtimit brenda vendit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
20	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	Në realizim e sipër
21	Mbul. i norm. të interesit për biznes. e reja	Në realizim e sipër
22	Kontrolli teknik i automjeteve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
23	Shërbime tjera kontraktuese	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
24	Rrjeta gjeodezike	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
25	Mirëmbajtje e mobilieve dhe pajisjeve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
26	Sinjalizimi vertikal dhe horizont. i rrugëve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës

Duke u bazuar në planifikimin e prokurimeve për vitin fiskal 2018, nga gjithsej 26 prokurime të planifikuara janë iniciuar 11 projekte (shërbime) apo shprehur në përqindje 42.30% të prokurimeve të planifikuara, ndërsa të paincuar janë 15 projekte apo shprehur në përqindje 57.70% të prokurimeve të planifikuara.

### II. 3) KONTRATAT PËR PUNË

Nr. Rendor	Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Projekti është realizuar PO / JO
1	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Novolan (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
2	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Smrekonicë (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
3	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Beçuk	Në realizim e sipër
4	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Galicë (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
5	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Brusnik (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
6	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Maxhunaj (trevjeçar)	Në realizim e sipër
7	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Samadrexhë (trevjeçar)	Në realizim e sipër
8	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Reznik (lagja "Mustafa, Curri dhe Makiqi") dhe në fshatin Shallc (trevjeçar)	Në realizim e sipër
9	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Sllakoc (trevjeçar)	Në realizim e sipër
10	Asfaltimi i rrugës Vushtrri -Nedakoc-Pestovë (trevjeçar)	Nuk është iniciuar nga njësia e kërkesës
11	Asfaltimi i rrugës Sllatinë-Tërllobuq (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
12	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pantinë (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
14	Asfaltimi i rrugës Stanoc-Lumadh-Prelluzhë-Gracë (dyvjeçar)	Anuluar, në mungesë të ofertave
15	Asfaltimi i rrugëve lokale në tri Dumnicat (trevjeçar)	Në realizim e sipër
16	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Ropicë	Në realizim e sipër
17	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Ceceli (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
18	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Studime e Epërme (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
19	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Studime të Poshtme (dyvjeçar)	Në realizim e sipër

20	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Sfaraçak (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
21	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Akrashticë (trevjeçar)	Në realizim e sipër
22	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pestovë	Në realizim e sipër
23	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Banjskë (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
24	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Dobërllukë (trevjeçar)	Në realizim e sipër
25	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Bukosh	Në realizim e sipër
26	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Vërnice	Në realizim e sipër
27	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Duboc (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
28	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Beçiq (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
29	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Shalc (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
30	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pasomë (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
31	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Ashlan (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
32	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Mihaliq (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
33	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Stroc	Në realizim e sipër
34	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Bivolak (dyvjeçar)	Në realizim e sipër
35	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Balincë	Në realizim e sipër
36	Rrugët e rendit të katërt	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
37	Ndërtimi i trotuareve	Në realizim e sipër
38	Mirëmbajta e rrugëve të asfaltuara	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
39	Projektet në bashkëfinancim me donatorë	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
40	Ndërtimi i parqeve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
41	Ndërtimi i banesave për familjet e dëshmorëve, invalid të luftës së UÇK-së (trevjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
42	Ndërtimi i urës në fshatin Dobërllukë	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
43	Platoja dhe gjelbërimi te banesat e bardha (trevjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës

44	Ndërtimi i impiantit (trevjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
45	Ndërtimi i shtratit të lumit "Podrança" me infrastrukturë Sllatinë (trevjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
46	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
47	Rregullimi i shtratit të lumit "Silnica"	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
48	Ndërtimi i lapidarit për martirët e luftës së dytë botërore dhe luftës së UÇK-së	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
49	Ndërtimi i fushave sportive	Në realizim e sipër
50	Renovimi i shkollave	Në realizim e sipër
51	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Stanoc të Epërm (trevjeçar)	Në realizim e sipër
52	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Beçuk	Në realizim e sipër
53	Ndërtimi i punëtorisë dhe kabineteve në shkollën e mesme teknike (trevjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
54	Ndërtimi i aneksit të qendrës rezidenciale	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
55	Renovimi i QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve qendrore me pelet	Në fazën e inicimit të aktivitetit
56	Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi"	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
57	Renovimi dhe adoptimi i dy zyrave	E realizuar
58	Renovimi i stadiumit të futbollit (dyvjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
59	Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit të futbollit	Në realizim e sipër
60	Ndërtimi i kullës së UÇK-së në fshatin Zhilivodë (dyvjeçar)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
61	Rregullimi i kulmit, ngrohjes qendrore dhe ventilimi i palestrës së sportive (dyvjeçar)	Në fazën e inicimit të aktivitetit
62	Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
63	Projektet me bashkëfinancim me donatorë (bujqësi)	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
64	Rregullimi i varrezave	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
65	Ndërtimi i lapidarëve, Stroc	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
66	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni	Në realizim e sipër

Duke u bazuar në planifikimin e prokurimeve për vitin fiskal 2018, sa i përket projekteve kapitale/punëve nga numri i përgjithshëm prej 66 prokurimeve, janë inicuar 43 projekte kapitale apo shprehur në përqindje 65.15%, ndërsa të pa inicuar janë 23 projekte apo shprehur në përqindje 34.85% të projekteve të planifikuara.

#### II.4) KONKURSET E PROJEKTIMIT

Nr. Rendor	Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
1	Harta zonale	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës

#### II. 5) KONTRATAT E PAPANIFIKUARA NË PLAN TË PROKURIMIT

Nr. Rendor	Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
1	Furnizimi me filma të rëntgenit për nevojat e QKMF-së	Kontratë kornizë me afat
2	Furnizim dhe montim i perdeve vertikale për objektin e ri të komunës	E realizuar
3	Furnizimi me reagensa për analizatorin hematologjik SFRI H18	Kontratë kornizë me afat
4	Ndarjet fizike brenda objektit të ri të komunës	E realizuar
5	Furnizimi, montimi dhe instalimi i kabllor optike për lidhjen e objekteve të administratës dhe shëndetësore me objektin e ri të komunës	E realizuar
6	Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi	Në realizim e sipër

#### II. 6) PROJEKTET KAPITALE TË BARTURA NGA VITI 2017, TË CILAT JANË NË REALIZIM E SIPËR

Nr. rendor	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e kontratës €
1	Ndërtimi i palestrës sportive në Samadrexhë të Vushtrrisë (projekt dyvjeçar)	786,371.04
2	Renovimi i shtëpisë së Mahmut agë Gjinollit në Vushtri	134,121.00
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit Vushtri-Gracë	468,649.70
4	Asfaltimi i trembëdhjetë (13) rrugëve lokale	156,815.49
5	Rrënimi i objektit të vjetër të komunës	17,229.82
6	Riasfaltimi i rrugës lokale Vushtri-Sllatinë	18,966.00
7	Zgjerimi, thellimi dhe pastrimi i shtratit të	81,554.01

	lumit "Llap"	
8	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni (faza e IV-të)	66,755.69
9	Ndërtimi i lapidarit në fshatin Gllavatin (faza e I-rë)	0.00
10	Rregullimi i varrezave	0.00
11	Ndërtimi i qendrës së kulturës "Hasan Prishtina" në Vushtrri	1,178,132.50
	<b>TOTALI:</b>	2,908,595.25

## Administrata

### Punët e kryera me rëndësi:

Është zgjatur orari i punës nga ai që ka qenë me punë me palë nga 8:30 deri 15:30, me pauzë nga 12:00 deri në 13:00, duke e bërë orarin me palë nga ora 8:30 gjer në orën 16:00 pa pauzë, që i bie çdo ditë nga 1 orë e 30 min më shumë shërbim për qytetarët apo brenda jave afër një ditë pune më shumë.

Themelimi i Qendrës së thirrjeve me numrin 0800 42000, pa pagesë për qytetarë. Numri 42000 është kodi postal i Vushtrisë, prandaj e kemi përzgjedhur këtë numër që qytetarët ta mbajnë më lehtë në mend.

Është filluar me dhënien e 3 dokumenteve që më herët nuk janë dhënë në Vushtrri, dokumente këto të nevojshme kryesisht për bashkatdhetarët: *Mbajtës i familjes, Shtesa për fëmijë, Tatimi mbi pagë* (studentët që punojnë punë sezonale në diasporë).

Është riorganizuar projekti për kalim në objektin e ri, për ta bërë sa më të lehtë qasjen e qytetarëve në të. Gjithashtu jemi përpjekur që 90% të shërbimeve për qytetarët t'i vendosim në katin përdhës pasi që qasja aty është më e lehtë. Po ashtu janë vendosur sportele të gjendjes civile, Drejtorisë së Bujqësisë, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe arkave (këto nuk kanë qenë të parapara në të kaluarën).

### Zyra e gjendjes civile

Prej datës 1.4.2018 kemi filluar bashkëpunimin me spitalin e qytetit për raportimin e të gjitha fakteve të lindjes që ndodhin në këtë spital. Kemi dërguar në trajnim të gjithë (14 zyrtarë) zyrtarët e gjendjes civile, trajnimi është organizuar nga Agjencioni i Regjistrimit Civil dhe nga IKAP-i. Gjithashtu Zyra e gjendjes civile ka marrë pjesë në projektin për daljen në terren së bashku me UNHCR, UNICEF dhe Kryqin e Kuq të Kosovës, për t'i evidentuar dhe regjistruar fëmijët që nuk janë të regjistruar në regjistrat e të lindurve të gjendjes civile për shkakun e mosdeklarimit nga ana e prindërve. Nga rastet që janë evidentuar në terren, janë gjetur 27 fëmijë dhe 4 persona të moshës madhore të paregjistruar, kryesisht janë fëmijë të komunitetit RAE.

Në Zyrën e gjendjes civile në Komunën e Vushtrisë, i gjeni të pasqyruara në raportin e detajuar në formë tabelare.

Nga E-Kiosku janë lëshuar 1299 dokumente të gjendjes civile.

Për punën që është bërë gjatë kësaj periudhe prej 1.1 - 25.6.2018 në Zyrën e gjendjes civile, i gjeni të pasqyruara në raportin e detajuar në formë tabelare.



Qendra për shërbim të qytetarëve

Nr.	Përshkrimi	Nr. i kërkesave	Përqindja
1	Drejtoria për Administratë	22,213	70,74%
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	5,554	17,69%
3	Personeli	500	15,92%
4	Drejtoria për Arsim	500	15,92%
5	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	417	13,28%
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	382	12,17%
7	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	362	11,53%
8	Drejtoria për Shërbime Publike	356	11,34%
9	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	348	11,08%
10	Drejtoria për Inspektime	281	8,95%
11	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	218	6,94%
12	Kryetari i komunës	89	2,83%
13	Zyra ligjore	64	2,04%
14	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	56	1,78%
15	Zyra lokale e komuniteteve	25	0,80%
16	Drejtoria e Prokurimit	13	0,41%
17	Kuvendi i komunës	10	0,32%
18	Nuk ekziston si departament, por ka lëndë	6	0,19%
19	Njësia e auditimit të brendshëm	4	0,13%
20	Zyra për integritet evropian	1	0,03%
		31,399	

## Qendra e thirrjeve

Më 15 mars 2018, Komuna e Vushtrrisë inauguroi Qendrën e thirrjeve për qytetarë, e cila u ofron qytetarëve të komunës shërbime më të mira, informim dhe transparencë. Gjatë këtyre muajve, qendra e thirrjeve ka pranuar 262 telefonata të qytetarëve. Në 83 ditë pune sa ka pasur gjatë kësaj periudhe, mesatarja e thirrjeve ka qenë nga 3.15 telefonata në ditë. 129 qytetarë kanë marrë informacion drejtpërdrejt nga telefonata.

Janë transferuar 40 telefonata tek zyrtarë përgjegjës komunal. 61 kërkesa janë proceduar tek drejtoritë përkatëse, 32 qytetarë kanë mbetur të informohen më vonë.

## Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative

<b>Përshkrimi i punëve dhe detyrave të kryera</b>	
Formatizime, instalime të aplikacioneve ose softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e problemeve softuerike.	64
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	98
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	66
Postime në ueb faqe dhe mirëmbajtje e ueb faqes zyrtare	120
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës, si dhe konsultime për lekturim.	135
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulant sipas nevojës të organeve komunale	81
Riparime dhe punë të ndryshme sipas kërkesës së zyrtarëve për mirëmbajtje të objektit komunal.	26

## Shërbime publike

Në fushën e shërbimeve publike janë bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Pasi që është lëshuar në funksion fabrika për përpunimin e ujit, kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike, si dhe krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë. Gjatë kësaj periudhe është bërë kyçja e “Lagjes së Vreshtave” në rrjetin e ujësjellësit përmes sistemit të pompimit dhe po ashtu jemi duke bërë përpjekje që të gjejmë mënyrën e kyçjes së konsumatorëve në fshatrat ku është shtrirë rrjeti primar.

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit në kuadër të planifikimit, kanë vazhduar investimet përmes realizimit të kontratave dyvjeçare sidomos në shtrirjen e rrjetit primar në një numër të konsiderueshëm të fshatrave: si Pantinë, Pestovë dhe Pasomë, si dhe ka filluar ndërtimi i kolektorit kryesor të Ura e Gurit. Po ashtu është zhvilluar procedura e tenderimit dhe është nënshkruar kontrata për furnizim dhe shpërndarje të gypave për komunitetin në shumë lokalitete ku ka nevojë në ç’rast janë duke u pranuar dhe verifikuar kërkesat e qytetarëve në bazë të të cilave do të bëhet lista për furnizim. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni në vlerën rreth 66 000 euro, që kanë qenë të kontraktuara dhe jemi në fazën e pranimit teknik të tyre, si dhe janë zhvilluar procedurat e tenderimit për ndërtimin e rrugëve dhe trotuareve tjera të planifikuara për këtë vit, pasi që janë hartuar paramasat dhe paralogaritë për ndërtimin e tyre.

Te ndriçimi publik është përmbyllur kontrata e mirëmbajtjes rutinore në vlerën 10 195 euro dhe është në procedurë të tenderimit kontrata tjetër për këtë vit, ndërsa në bashkëpunim me Unionin Evropian është duke u hartuar Plani komunal i veprimit për eficiencë të energjisë. Në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të

mbeturinave dhe me qëllim të arritjes së objektivave të Planit lokal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave, kemi qenë të përkushtuar në:

- krijimin e mekanizmit institucional përmes emërimit të zyrtarit për menaxhim të mbetjeve dhe
- krijimin e mekanizmit financiar përmes planifikimit të taksës për mbeturina si e hyrë komunale.

Përveç këtyre, Komuna e Vushtrrisë ka ndërtuar një partneritet të qëndrueshëm me GIZ-in, i cili partneritet ka ndikuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve të grupit punues, për formësimin e idesë dhe konceptit për menaxhimin e mbetjeve si shërbim prioritar për qytetarët. Në kuadër të marrëveshjes të nënshkruar me GIZ-in kanë filluar të realizohen një varg pilotprojektesh si:

- Projekti për ndarjen e mbetjeve në burim për zonën e qytetit dhe në të gjitha institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë, i cili ka filluar së zbatuari nga data 17.04.2018;
- Plani i ri operativ që parasheh ofrimin e shërbimit në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë, i cili ka filluar së zbatuari nga data 23.4.2018, pra kemi arritur të shtrijmë shërbimin në tërë territorin e komunës;
- Kompostimi për zonën e përzgjedhur në fshatin Bukosh me rreth 150 ekonomi familjare që përfshin furnizimin me 150 komposterë 300 [l] në ç'rast shpërndarja e tyre është bërë më datë 20.6.2018;
- Rishikimi i modelit të operimit që parasheh: kontraktimin e shërbimit me ndërmarrjen "Uniteti" për tërë territorin e komunës, mbledhjen e taksës për mbeturina si e hyrë komunale nga muaji korrik 2018, krijimi dhe zhvillimi i një softwari pra sistemi i menaxhimit të të dhënave së bashku me listën e ekonomive familjare, profilizimin e klientëve, mënyrën e llogaritjes së kostos dhe nevojave financiare, shpërndarjen e faturës, mënyrën e pagesës, fushatën e vetëdijesimit publik, formimin e një komisioni këshillues, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të projektit.

Prej nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje përfitimet e Komunës së Vushtrrisë kanë qenë shumë të mëdha. Përveç asistencës së vazhdueshme teknike përmes konsulentëve të angazhuar nga GIZ-i si: GAC-it, CE&AE-së dhe OJQ-së JESHIL, për hartimin e planeve të cekura më lartë, komuna dhe ndërmarrja janë furnizuar me 262 kontejnerë 1.1 [m<sup>3</sup>] në vlerën rreth 90 000 €, 200 kontejnerë 240 [l] për ndarje të mbeturinave në institucione, si dhe furnizimin me 700 kontejnerë familjarë 120 [l] për mbledhje të mbetjeve derë më derë. Kur jemi te projekti i grumbullimit të mbetjeve të diferencuara, GIZ ka financuar rregullimin e katër platove me rrethojë dhe mbulesë metalike për vendosjen e kontejnerëve të veçantë për hedhje të mbeturinave të ndara. Kontejnerët që janë vendosur dallohen përmes ngjyrës së kapakëve. Po ashtu kemi planifikuar 25 000 € në ç'rast kemi zhvilluar procedurat dhe jemi furnizuar me 1315 kontejnerë familjarë 120 [l] për zgjerim të shërbimit. Gjatë kësaj kohe komuna ka angazhuar 6 punëtorë sezonal në mirëmbajtje të hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së pastërtisë në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës, si dhe është duke u bërë punë e mirë në terren. Gjithashtu është realizuar kontrata për mbjelljen e një numri të konsiderueshëm të drunjtve dekorativ dhe luleve në qytet.

Pra, tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim ka mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e qëndrueshëm të deponive ilegale, rritjen e shkallës së inkasimit përmes mekanizmave kushtëzues që parasheh Rregullorja për menaxhim të mbetjeve, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim apo promovimit të 3R, si dhe procesit të kompostimit.

Gjithashtu në kuadër të Raportimit të Sistemit për Menaxhim të Performancës në ofrimin e shërbimeve komunale, në bazë të rezultateve të publikuara para një muaji kemi përfituar 144 600 euro. Në fushën e trafikut investimet kanë vazhduar në bazë të kontratës kornizë për furnizim dhe vendosje të shenjave edhe pse vlera për këtë vit ka qenë simbolike, pra jemi në përfundim të kontratës, mirëpo aktualisht Drejtoria për Shërbime Publike është duke bërë shqyrtimin e mundësive për implementim të projekteve të listuara në Planin e mobilitetit përmes të cilit, Komuna e Vushtrrisë synon të krijojë një rrjet funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pamotorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta.

Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve të asfaltuara janë zhvilluar punime dhe është bërë përmbyllja e kontratës kornizë dyvjeçare dhe janë në zhvillim e sipër procedurat për kontraktimin e mirëmbajtjes për rrugët lokale.

Po ashtu është në përmbyllje kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr, për të filluar pastaj procedurat për kontratën kornizë në bazë të planifikimit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kilometrat e kaluara, si dhe karburantet e harxhuara për automjetet, për periudhën janar – qershor 2018.

Muaji	Km të kaluara	Litra	Mesatarja
Janar	12305	1118	9.08
Shkurt	15874	1671	10.52
Mars	16546	1653	9.99
Prill	19308	2025	10.48
Maj	20857	1662	7.96
Qershor	20246	1827	9.02
<b>Total</b>	<b>105 136 [km]</b>	<b>9 956 [l]</b>	<b>9.46 [l/100km]</b>

Gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar janë realizuar 100 407 km, ndërsa janë shpenzuar 10 420 litra apo 10.37 l/km. Ndryshimi për periudhën e njëjtë kohore është 464 litra shpenzime më pak, si dhe ulje të shpenzimeve për 0.91 l/km.

### Gjeodezi, kadastër dhe pronë

Në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. Rend.	LËNDËT E ARRITURA Janar- qershor 2018	Gjithsej
1.	KËRKESAT E ARRITURA	<b>5554</b>
2	AKTVENDIME PËR BARTJE	<b>614</b>
3.	AKT. PËR KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRA.	<b>72</b>
4.	AKTVENDIME PËR REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>85</b>
5.	AKTVENDIME PËR ÇREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>30</b>
6.	VËRTETIME-CERTIFIKATA	<b>465</b>
7.	COPTIMI-NDARJE FIZIKE	<b>187</b>
8.	INCIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	<b>12</b>
9.	UZURPIMET	<b>6</b>
10.	KOPJE TË PLANIT	811
11.	LISTA POSEDUESE	3954
12.	KËRKESA ZYRTARE TË NDRYSHME	<b>86</b>
13.	SHPRONËSIME	<b>1</b>
14.	LËNDËT NË PROCEDURË	<b>39</b>
15	Kërkesa tjera (identifikim, dalje në terren, ankesa etj).	<b>122</b>

- Janë pranuar 614 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë miratuar 592 kërkesa të palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje janë edhe 22 kërkesa.
- Janë pranuar 72 kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave dhe janë aprovuar 70 kërkesa të tilla, ndërsa 2 prej tyre janë refuzuar.
- Janë aprovuar 85 kërkesat për regjistrimin e hipotekave dhe 30 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave,

- Për nevoja të aplikuesve të ndihmës sociale janë lëshuar 1270 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme, si dhe 415 certifikata pronësore.
- Janë lëshuar 3954 certifikata pronësore dhe 811 kopje të planit.
- Është zhvilluar procedurë e shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik në fshatin Ceceli.
- Janë futur në sistemin zyrtar SIKTK të dhënat për pronat në masën komasative dhe tani qytetarët për këto prona mund të pajisen me certifikata të pronës.
- Në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë futur në gjeoportali shumica e zonave kadastrale të Komunës së Vushtrrisë dhe së shpejti pritet ky proces të përfundojë.
- Kemi marr iniciativën që në bashkëpunim me USAID-in amerikan të instalojmë E-kiosk në mënyrë që qytetarët të mund të marrin certifikatën pronësore përmes këtij shërbimi.

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevoja të komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.).

### Urbanizëm dhe mbrojtje e mjedisit

Në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit brenda kësaj periudhe kohore janë kryer këto punë:

#### Spektori i urbanizmit

Janë dhënë këto kushte ndërtimore:

Për objektet e kategorisë së parë (I) të ndërtimeve ....	7
Për objektet e kategorisë së dytë (II) të ndërtimeve ....	5
Në proces janë gjithsej .....	15
Informime nga plani (PZHK) .....	4
Pëlqime .....	4
Pëlqime .....	5
Refuzime .....	8
Të hedhura poshtë .....	9
Informime për plotësim të lëndëve .....	15

#### Leje ndërtimi:

Për objektet e kategorisë së parë (I) të ndërtimeve janë dhënë tri (3) leje ndërtimi  
 Për objektet e kategorisë së dytë (II) të ndërtimeve janë dhënë tri (3) leje ndërtimi

#### Spektori i planifikimit

• Pëlqime paraprake .....	26
• Pëlqime tjera .....	9
• Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore.....	3
• Shfrytëzim të hapësirave publike .....	26
• Refuzime të hapësirave publike .....	7
• Refuzime .....	9
• Informime .....	12
• Në proces .....	3

Punët tjera

- Mbikëqyrje të projekteve..... 10
- Vlerësim i tenderëve..... 2
- Pranime teknike..... 1
- Takime me UN-Habitat ..... 1

Inspektimet**Punët e kryera të paraqitura në mënyrë tabelare**

Nr. rend	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	Numri	Vlera
1	AKTIVITETE INSPEKTUESE	1134	
2	PROCESVERBALE	460	
3	AKTVENDIME/ URDHËRESA TË NDRYSHME	273	
4	FLETËPARAQITJE NË GJYKATË	31	
5	PRANIME TEKNIKE	48	2050.00€
6	PËLQIME SANITARE	18	2557.23€
7	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE	10	125.00€
8	MOSTRA TË MARRA TË USHQIMIT	-	
9	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJËSIM I MALLIT	685.18 kg	
10	PAGESË PËR ASGJËSIM TË MALLRAVE	70.00€	
11	KËRKESA TË PRANUARA	266	
12	KËRKESA TË MIRATUARA	259	
13	KËRKESA TË REFUZUARA	7	
14	KËRKESA NË PROCEDURE	-	
15	DËNIME MANDATORE	12	1400.00€
16	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	3	

## Shëndetësi dhe përkujdesje sociale

### Punët që janë kryer:

- Heqja e kufizimit për numrin e analizave në laborator.
- Trajtimi i gjitha lëndëve të shkeljeve në komisionin disiplinor.
- Memorandumi me Islamic Relief për “Vizita dhe ofrim i shërbimeve shëndetësore në shtëpi”, për të moshuarit, lehonat, shtatzënat, të aksidentuarit, të sëmurët kronik etj. Për 4 muaj sa është duke funksionuar kjo marrëveshje mes Islamic Relief-komunë për vitin 2018 kemi gjithsej 1.080 pacientë, me mbi 3.849 shërbime të ofruara për këta 4 muaj, dhe nga numri i përgjithshëm i pacientëve, 632 kanë qenë të gjinisë femërore dhe 448 pacientë të gjinisë mashkullore.
- Ndalesa e reklamimit të kompanive private farmaceutike apo agjentëve të tyre brenda hapësirave të QKMF, QMF dhe AMF të Komunës së Vushtrrisë.
- Ndarja e subvencioneve dhe mbështetja e projekteve të OJQ-ve me anë të thirrjes publike transparente dhe të bazuar në kritere si praktikë që aplikohet për herë të parë.
- Rregullimi dhe funksionalizimi i Këshillimores për edukim shëndetësor dhe këshillim motivues për pacientë me diabet dhe ata me hipertension në QMF 1.
- Rregullimi dhe funksionalizimi i shërbimit të urgjencës 24 orë në QMF 1.
- Realizimi i vizitave dhe kontrolleve sistematike për nxënësit në shkollat e komunës sonë.
- Ndarja e mjeteve financiare dhe subvencionimi i 125 rasteve me sëmundje të rënda ose me gjendje të vështirë ekonomike momentale në vlerë totale prej 23 500 Euro.
- Futja në funksion e aparaturës moderne në laborator, rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve laboratorike në QKMF.

Nga data 1.1.2018 deri më 30.6.18 në QKMF dhe qendrat tjera shëndetësore në komunën tonë kanë kërkuar dhe kanë marrë shërbim shëndetësor gjithsej 117.119 pacientë. Nga numri i përgjithshëm i pacientëve të vizituar 48.997 i kanë takuar gjinisë mashkullore, ndërsa 68.122 janë të gjinisë femërore. Qytetarët kanë marrë gjithsej 296.177 shërbime të ndryshme shëndetësore, ndërsa gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 janë vizituar 99.897 pacientë dhe numri i shërbimeve të ndryshme shëndetësore ka qenë 187.090 shërbime, që d.m.th. gjatë këtij gjashtëmujori të vitit 2018 kemi rritje të numrit të vizitave dhe shërbimeve në krahasim me vitin paraprak në qendrat tona shëndetësore, kjo tregon se qytetarit ia kemi kthyer besimin në institucionet shëndetësore publike të kujdesit parësor shëndetësor të Komunës së Vushtrrisë.

### Përkujdesja sociale

Shpërndarja dhe furnizimi me pako ushqimore, pako higjienike, miell dhe batanije përreth 1100 familje me kushte të rënda sociale.

Largimi i familjeve nga oborri (barakat) i ambulants së vjetër, shtëpisë së Mahmut agë Gjinollit dhe strehimi i këtyre familjeve me qira të mbuluara nga Komuna e Vushtrrisë.

Me iniciativën e Kryetarit të komunës në bashkëpunim me donatorët janë ndërtuar ose janë në ndërtim e sipër 4 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë të banimit. Po ashtu është dhuruar një banesë për një familje me gjendje të vështirë ekonomike e sociale dhuruar nga shoqata “Jetimët e Ballkanit”.

Në QPS–Vushtrri në asistencë sociale janë 1491 familje. Në kategorinë e parë janë 893 familje, kurse 538 prej tyre janë në kategorinë e dytë. Janë parashtruar 167 kërkesa për asistencë sociale prej të cilave 69 janë aprovuar,

Kurse 82 prej tyre janë refuzuar si familje të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret, si dhe janë riaktivizuar 37 familje. Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 18, prej tyre 11 janë aprovuar në vlerë prej 100 € dhe një në vlerë prej 300 €.

## **Kulturë, rini dhe sport**

### Kultura

Në kuadër të Qendrës së kulturës janë mbajtur manifestime dhe akademi për nder të ditëve të veçanta sikurse janë: akademi solemne për dhjetëvjetorin e Pavarësisë të Republikës së Kosovës, 7 Marsi - Dita e Mësuesit, akademi për 2 dhe 22 Maj, pastaj Dita e Çlirimit, ku edhe u hap ekspozita e piktorëve vushtrrias etj. Pjesëmarrje e ansambllit “H. Prishtina” në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare ku janë arritur rezultate kulminante.

### Biblioteka

MKRS ka ndarë 2500 Euro subvencion për pasurimin e fondit librar në bibliotekë.

Aktivitetet:

- Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 3108 libra;
- në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 1764 libra;
- sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 793 lexues;
- janë përpunuar 280 libra, dhe
- lexues të regjistruar 277;
- në dy sektorët e bibliotekës, janë dhënë për lexim 4872 libra;
- në bibliotekat në terren janë dhënë për lexim 3764 libra, ndërsa lexues të regjistruar janë 506.

Gjithsej libra të dhëna për lexim janë 8636, ndërsa lexues të regjistruar 783, kurse gjatë periudhës janar - prill 2018 janë pranuar dhuratë 438 libra (ekземplarë me tituj të ndryshëm).

### Muzeu

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore muzeu ka pasur aktivitete, intervista dhe vizita të ndryshme:

- Paketimi dhe bartja e pasurisë muzeale nga lokalet e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” në hapësirat e SHMU-II, më 16.5.2018.
- Mbledhje e pasurisë muzeale-eksponate dhe fotografi, dhe arkivim i 56 eksponateve nga fusha e arkeologjisë dhe etnologjisë, si dhe 44 fotografi të vjetra, të cilat rrëfejnë për mënyrën e jetesës, veshjet, traditat qytetare, qytetin e vjetër, “Luftën e vitit 1999”, etj.
- Muzeu punoi edhe në inventarizimin digjital të mbi 80 eksponateve arkeologjike e etnologjike.
- Muzeu ka punuar edhe në hulumtimin dhe identifikimin e monumenteve nga kultura materiale e paluajtshme dhe të luajtshme, duke identifikuar dhe përshkruar dhjetëra monumente e objekte nga kultura e vjetër vushtrriase, si dhe vazhdimi i punëve hulumtuese në fushën e trashëgimisë shpirtërore.
- Me qëllim të vjeljes dhe arkivimit të materialit të trashëgimisë kulturore, muzeu zhvilloi vizita dhe intervista me familjet, siç janë: familja e Hazir Gjakës, familja Bllata, Kuçani, Ademi, Feka, Bunjaku, Sylejmani, etj.
- Për nder të manifestimit “Binjakëzimi i Komunës së Vushtrrië me Komunën IOWA (Amerikë)”, Muzeu Historik Etnografik organizoi ekspozitën fotografike “Pamje të vjetra të qytetit të Vushtrrisë”, si dhe gjatë realizimit të manifestimit, përmes sllajdeve prezantoi qytetin e vjetër të Vushtrrisë.
- Ndër aktivitetet tjera të punës hulumtuese të muzeut, rëndësi të veçantë iu kushtua pritjes së vizitorëve dhe prezantimit të kulturës materiale e shpirtërore të vendit, të cilët vizituan muzeun për të mësuar më shumë për pasuritë e muzeut të Vushtrrisë dhe trashëgiminë kulturore.



### Arkivi

Gjatë këtij gjashtëmujori janë regjistruar, klasifikuar dhe sistemuar 67 kuti arkivore të niveleve të ndryshme: civile, ndryshime, vërtetime të kontratave, si dhe trashëgimi. Dokumentacioni i sistemuar sipas njësisë organizative, lëndëve dhe viteve gjithsej i përfunduar 5700 lëndë.

### Teatri

- Me teatrin e fëmijëve janë mbajtur prova me fëmijët për përgatitjen e tyre si aktorë, është punuar rregullisht që të lirohen në skenë, në mënyrë që të fillohet për realizimin e shfaqjes së fëmijëve.
- Për nder të 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë, teatri ishte i angazhuar në 10 vjetorin e pavarësisë.
- Më 12 prill teatri ka njoftuar të gjithë të interesuarit për garën e recitatorëve dhe kjo garë është mbajtur më 23 dhe 24 prill. Interesimi ishte i jashtëzakonshëm dhe mbi 100 fëmijë kanë marrë pjesë në ditën e parë më 23 prill, ndërsa në ditën finale më 24 prill ishin 21 garues finalistë. Fituese u shpall Tuana Grabovci e cila mblodhi më së shumti pikë nga juria Fazli Muharremi, Naser Shala dhe Milazim Sejdiu.
- Akademi përkujtimore për dëshmorin e kombit Jashar Jashari.

### Sporti

Janë organizuar gara dhe turne të ndryshme në rastin e shënimit të përvjetorëve si: 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 1 Qershorit-Ditës ndërkombëtare të fëmijëve, Ditës së Çlirimit të Vushtrisë etj.

### Rinia

Janë financuar OJQ-të rinore, dhe OJQ tjera përmes thirrjes publike. Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme rinore përmes KVRL-së dhe OJQ tjera rinore.

Spektori për rini në Vushtri në bashkëpunim me KVRL-në në rastin e “Ditës Botërore të Ujit”, ka organizuar një aktivitet sensibilizues, për rëndësinë e ujit në shëndetin e njeriut, si dhe përkujdesjen ndaj ujit (në këtë aktivitet është bërë edhe shpërndarja e broshurave me përmbajtjen e cekur më lart).

Është mbajtur trajnimi “Zhvillimi dhe fuqizimi i Qendrave Rinore në Kosovë”. Ky trajnim kishte për qëllim planifikimin strategjik rinor, si dhe avokimin për qendrën rinore ku pjesë e trajnimit ishin edhe anëtarët e KVRL-së së bashku me qendrën rinore "Hareja" dhe anëtarët e KVRL-së dhanë një kontribut për planin strategjik rinor, kurse në fund të këtij projekti do të nxirret një strategji për dhjetë (10) qendrat pjesëmarrëse.

### Mbrojtje dhe shpëtim

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka përcjell në vazhdimësi situatën në terren për mbrojtje të popullatës dhe të mirave materiale nga fatkeqësitë e mundshme elementare, me theks të veçantë vërshimet nga reshjet atmosferike, duke u fokusuar në vendet ku vazhdimisht ka ekzistuar rreziku i daljes nga shtrati i lumit “Silnicë” si në: Pestovë, Nedakoc, Vërnice, Prelluzhë, Mihaiq dhe Studime. Si pasojë e vërshimeve që filluan në fillim të muajit mars 2018, është angazhuar kompania e kontraktuar për situata emergjente e cila ka intervenuar në fsh. Prelluzhë dhe Akrashticë në ç’rast 7 familje rrome me 44 anëtarë në fsh. Prelluzhë janë evakuuar dhe janë strehuar tek të afërmit e tyre. Gjithashtu në fsh. Nedakoc një familje 6 anëtarëshe ka mbetur e bllokuar nga uji. Kjo familje nuk ka pranuar të evakohet nga shtëpia e vet, por është furnizuar me ushqim dhe ujë të pijshëm. Po ashtu është përcjellë gjendja e përgjithshme në terren dhe kompania “WENDA” ka intervenuar në fsh. Pestovë dhe te ura e lumit “Silnica” në Vushtri.

- Duke u nis nga një situatë e tillë e krijuar, DMSH ndërmori këto veprime dhe masa për tejkalim të gjendjes së krijuar: ekipi emergjent u obligua të punojë dhe ta përcjellë situatën në terren pa ndërprerë. U koordinuan aktivitete edhe me Policinë e Kosovës në Vushtrri e cila ka ndihmuar për menaxhim më të mirë të situatës në terren, si dhe njësinë e zjarrfikësve e cila gjithashtu është angazhuar me mekanizmin përkatës për t'iu dalë në ndihmë ekipeve në terren dhe me Kryqin e Kuq në Vushtrri. Përmes mediave është bërë informimi dhe apeli tek qytetarët që të kenë kujdes gjatë kësaj situatë dhe të përcjellin gjendjen dhe të marrin masat e sigurisë për çdo të papritur që mund t'ju ndodhë. Qendra lokale e koordinimit emergjent ka aktivizuar planin për koordinim me të gjitha ekipet në terren dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me ekipet në terren.

Ky raport konsiderojmë se është gjithëpërfshirës, megjithatë i mirëpresim sugjerimet e juaja gjatë diskutimeve në mbledhje të Kuvendit të komunës.



Kryetar i Komunës

Xhafer Tahiri